

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR QYTETIN E TIRANËS

- Qyteti i Tiranës kufizohet në veri nga Kodër-Kamëz me lartësi 112 m mbi nivelin e detit; në jug nga Selita me lartësi 303 m mbi nivelin e detit; në perëndim nga Universiteti Bujqësor dhe në lindje nga Kodra e Surelit me lartësi 418 m mbi nivelin e detit.
- Temperatura mesatare vjetore është 16°C.
- Sasia mesatare e reshjeve është 1,297 mm.
- Tirana përshkohet nga 2 lumenj kryesorë: Lumi i Lanës (nga Ish Autotraktorët tek Rezervati i Peshkut) me gjatësi 15.3 km dhe Lumi i Tiranës (nga shkalla e Tujanit tek Universiteti Bujqësor) me gjatësi 10.25 km.
- Në Tiranë ndodhen 4 liqene: Liqeni i Tiranës, Liqeni i Kodër-Kamëz, Liqeni i Farkës dhe Liqeni i Tufinës.

Liqenet kryesore

Liqenet	Sipërfaqja (km ²)	Lartësia mbi nivelin e detit (m)	Thellësia maksimale (m)
Liqeni i Tiranës	0.55	118	4.5
Liqeni i Kodër Kamzës	0.25	173	3.2
Liqeni i Farkës	0.55	260	
Liqeni i Tufinës	0.04	240	


Sipas **Zyrës së Gjendjes Civile** pranë Bashkisë së Tiranës, popullsia e qytetit deri në Dhjetor 2007 arrin në rreth 607,467 banorë, nga të cilët 49.7% janë meshkuj dhe 50.3% janë femra.

Të dhënat demografike paraqiten në mënyrë të detajuar në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Njësia Bashkiake	Popullsia banuese në fund të vitit	Të ardhur	Të larguar	Lindje	Vdekje	Nr. i
						Martesave
1	51,007	1,464	783	583	261	450
2	72,801	1,460	1,241	830	363	449
3	43,100	795	1,474	469	229	358
4	66,795	1,031	1,166	495	247	397
5	74,936	2,003	960	625	369	688
6	60,384	1,196	1,353	930	227	693
7	61,362	1,888	882	709	296	329
8	37,931	746	568	416	231	297
9	51,599	1,617	798	457	272	447
10	26,457	646	356	170	211	199
11	61,095	1,588	1,355	886	234	683
Gjithsej	607,467	14,434	10,936	6,570	2,940	4,961

Viti 2007

Popullsia banuese në Tiranë sipas Njësisve Bashkiake



Nëse do të bënim një krahasim të të dhënave demografike të vitit 2007 me ato të vitit 2006 do të vinim re një rritje të:

- Popullsisë me 1.2%
- Martesave me 5.5%

Si dhe ulje të:

- Të të ardhurve me 46.7%
- Të të larguarve me 32.8%
- Të të lindurve 2%
- Të të vdekurve me 3.9%

Të dhëna historike

Data e themelimit të qytetit të Tiranës është viti 1614, ku nën kujdesin e Sulejman Pashë Bargjinit u krijua bërthama e parë e qytetit. Sot ajo i përgjigjet sheshit ku ndodhet monumenti “Partizani i Panjohur”. Në vitin 1789, filloi ndërtimi i “Xhamisë së Et’hem Beut” dhe në vitin 1839, ndërtimi i “Kullës së Sahatit”, që sot ndodhet në qendrën e qytetit. Më 25 nëntor 1912, dy ditë para shpalljes së pavarësisë, populli i Tiranës ngriti flamurin kombëtar.


Më 8 shkurt 1920, Qeveria e dalë nga Kongresi Kombëtar i Lushnjës, u vendos në Tiranë, e cila u bë kështu kryeqyteti i vendit. Në atë kohë, qyteti i Tiranës numëronte 17,000 banorë dhe zinte një sipërfaqe prej 3 km². Në vitin 1930, qyteti i Tiranës kishte 25,079 banorë dhe shtrihej në 8 km². Në vitin 1950, sipërfaqja arriti 10.6 km²; në vitin 1970 deri 31 km². Pas viteve 1990, u vu re një “bum” urbanistik. Duke iu referuar regjistrimit të parë të popullsisë, në shtator 1923, qyteti i Tiranës numëronte 10,845 banorë. Pas shpalljes së Tiranës kryeqytet të Shqipërisë, popullsia u rrit gradualisht.

Të dhëna arkeologjike

Mozaiku i Tiranës është i vetmi monument arkeologjik brenda territorit të qytetit të Tiranës. Në vitin 1972, gjatë punës për ndërtimin e pallateve të bllokut “Partizani” në lagjen nr. 9 të qytetit të Tiranës, u zbuluan rrënojat e një ndërtese antike, njëri nga ambientet e të cilit ishte i shtruar me mozaik. Sipas autorëve, kemi të bëjmë me një qendër fshatare të shekujve të parë pas Krishtit që në fillim të shek. III u zëvendësua me një vilë fshatare (rustica). Salla me mozaik e pajisur dhe me një absidë ishte ambjenti kryesor i saj. Autorët mendojnë edhe që në shek. V-VI vendin e vilës e zuri një bazilikë paleokristiane. Pjesa e gërmuar e monumentit u rrethua dhe u vu në mbrojtje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK). Gjatë viteve 2003-2004 punimet e sistemit të rrugëve dhe instalimeve të ndryshme të bllokut “Partizani” zbuluan pranë rrethimit të monumentit pjesë të tjera të kompleksit. Më kryesoret këtu ishin vaskat e fermentimit të mushtit të rrushit, por edhe pjesë të tjera muresh në dy pika të ndryshme. Brenda këtij kompleksi u zbuluan tre stela varresh të periudhës romake. Gërmimet e fundit përforcuan mendimin se kemi të bëjmë me një vilë fshatare, ndërkohë që nuk është gjetur asnjë e dhënë për transformimin në bazilikë paleokristiane të mbështetur nga autorët e gërmimit të parë të viteve '70. Në mënyrë konvencionale, siti arkeologjik është emërtuar dhe njihet me emrin “Mozaiku i Tiranës”.

STEMA E BASHKISË SË TIRANËS

Stema e Bashkisë është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 215, dt. 14.11.2000. Ka në bazë të saj stemën e Skurajve, e cila është familja që sundonte Tiranën në Mesjetë, në shekujt XIV-XV. Një nga gjurmët e gjetura nga kjo familje, në zonën rrëzë Malit të Dajtit, është Stema e Skurajve, e gjetur në një bllok guri, që sot gjendet në Muzeun Historik Kombëtar. Për qytetin e Tiranës, të lindur në vitin 1614, për të gjithë banorët e tij të dyqind vjetëve të fundit, si simbol dhe si pikë referimi ka shërbyer Kulla e Sahatit, që është monumenti më domethënës i shekujve të tij të fundit. Në stemën e qytetit përfshihet edhe një kurorë me tre kulla, e vendosur përsipër shqytit, që do të jetë një simbol i përbashkët për të gjitha stemat e qyteteve.



KËSHILLI BASHKIAK

Këshilli Bashkiak zgjidhet për një periudhë 4-vjeçare. Mandati i këshilltarit është i vlefshëm nga koha që këshilltarët bëjnë betimin dhe e nënshkruajnë atë, deri në konstituimin e Këshillit pasardhës.

Këshilli Bashkiak i Tiranës përbëhet nga 55 këshilltarë me përkatësi partiake si më poshtë:

Partia Socialiste	21 anëtarë
Partia Demokratike	17 anëtarë
Lëvizja Socialiste për Integrim	6 anëtarë
Partia Republikane	2 anëtarë
Partia Bashkimi i Legalitetit	1 anëtar
PAA	1 anëtar
Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut	1 anëtar
Partia Demokrate e Re (PDr)	1 anëtar
Partia Aleanca Demokratike	1 anëtar
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	1 anëtar
PDR	1 anëtar
Partia Socialdemokrate	1 anëtar
PDI	1 anëtar

Për vitin 2007, Këshilli Bashkiak i Tiranës ka miratuar gjithsej 80 vendime të cilat paraqiten më poshtë:

Datë 5.2.2007

1. Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit të qytetit.
2. Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.5, datë 27.2.2003 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të ndryshuar me vendimin Nr.7, datë 21.3.2005 dhe vendimin Nr.17, datë 27.3.2006.
3. Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës.
4. Për disa ndryshime në strukturën organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës.
5. Për caktimin e Njësive Bashkiake si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore si dhe për një shtesë në numrin e punonjësve në strukturën organizative.
6. Për miratimin e bonusit të strehimit për familjet në nevojë.
7. Për miratimin e sistemit të pikëzimit për formularët e strehimit në Tiranë.
8. Për kalimin kapital në administrim të Njesisë Bashkiake Nr.10, të asetit të aparatit të Bashkisë së Tiranës “Qendër Komunitare për të moshuarit”, deri në përfundim të projektit nga Banka Botërore.
9. Për miratimin dhe zbatimin e projektit “SWEB” (Shërbime mobile të sigurta, ndërvepruese dhe ndërkufitare, të cilat kontribuojnë për një bashkëpunim europian të besueshëm me vendet e Ballkanit Perëndimor jo anëtarë të BE) financiar me grant nga Komisioni Europian.

10. Për anëtarësimin e Bashkisë së Tiranës në rrjetin e Federatës Europiane për solidaritet lokal për koordinimin e “Ditës Europiane të Fqinjësisë së Mirë” (European Network on European Federation of Local Solidarity / European Neighbours’ Day Coordination)
11. Për një ndryshim në mënyrën e pagesës për orkestrën frymore dhe ansamblin folklorik “Tirana”
12. Për miratim dhënie burse shteti nxënësve dhe studentëve të viteve të para, në vitin shkollor 2006-2007.
13. Për emërtimin e një rruge të paemërtuar ne territorin e Njësisë Bashkiake Nr.5 “Rruga e të Dashuruarve”.

Datë 23.3.2007

14. Për miratimin e mandatit të këshilltarëve.
15. Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Bashkiak.
16. Për zgjedhjen e zv/kryetarit të Këshillit Bashkiak.
17. Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Qarkut.

Datë 30.4.2007

18. Për mbarimin para afatit të mandatit të këshilltarit Z.Arben Demeti dhe dhënien e mandatit Z.Gjete Ndoj.
19. Për emërimin e sekretarit të Këshillit Bashkiak.
20. Për kalimin e disa kompetencave Njësisë Bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të Njësisë Bashkiake dhe Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit.
21. Për një ndryshim të numrit të punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve .
22. Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.3, Datë 5.2.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”
23. Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007.
24. Mbi riorganizimin e disa ndërmarrjeve të Bashkisë së Tiranës.
25. Për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme.
26. Për heqjen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin e juridiksionit të Bashkisë së Tiranës të Ish Dyqanit të Artikujve Artistik.
27. Mbi caktimin e territorit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial si zonë me trafik të kufizuar.
28. Për një ndryshim në numrin e punonjësve të Policisë Bashkiake të Qytetit të Tiranës.

Datë 29.5.2007

29. Për mbarimin para afatit të mandatit të këshilltarit Z.Mero Baze dhe dhënien e mandatit Znj.Suzana Guxholli.

Datë 8.6.2007

30. Për emërtimin e Rrugës “Presidenti George W. Bush”

Datë 21.6.2007

31. Për zgjedhjen e anëtarit për Këshillin e Qarkut.

Datë 26.6.2007

32. Për miratimin në parim të financimit të projektit “Ndërtimi i banesave sociale me qera”, në qytetin e Tiranës nëpërmjet huasë me qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe buxhetit të Bashkisë së Tiranës.
33. Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.128, datë 30.10.2001 “Për krijimin e Këshillit teknik të D.P.P.P.”
34. Për pjesëmarrjen e Bashkisë së Tiranës në Panairin e Pushimeve Ndërkombëtare Zviceriane të Luganos (1- 4 Nëntor 2007).
35. Për miratimin dhe financimin e projektit “Të mësojmë duke vepruar”.
36. Për dhënien në administrim të objektit të Ish Ndërmarrjes Riparim Materiale Poligrafike Ministrisë së Drejtësisë.
37. Për kalim kapitali të objektit Palestra e Estradës Tiranë, Bashkisë së Tiranës.
38. Për kalimin kapital të zyrave të Uzinës Mekanike “Tirana” Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe miratimin e projektit të rikonstruksionit të kësaj godine.

Datë 28.9.2007

39. Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.63, datë 8.11.2005 “Për miratimin e Komisionit të Strehimit”
40. Për disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë së Tiranës.
41. Për revokimin e pjesshëm të V.K.B. Nr.6, datë 21.3.2005 “Për riorganizimin e Teatrit të Cirkut, Teatrit të Estradës, Qendrës Rekreative “Tirana” në Qendrën Kulturore “Tirana”, nivelin e pagave të punonjësve dhe kalimin kapital të pjesshëm të objektit të Qendrës Rekreative “Tirana”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit.
42. Për financimin e pjesshëm të projektit “Pilotimi i skemës së ndihmës së re ekonomike të shoqëruar me punë në komunitet në Njësitë Bashkiake Nr. 1,5,6,8,9,11.
43. Për miratimin dhe financimin e pjesshëm të projektit “Qendër ditore komunitare për të moshuarit, në Njësitë Bashkiake Nr.7 dhe 8”.
44. Për miratimin e listës së pjesshme (pjesa e katërt) të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës.
45. Mbi sistemimin me zyra të Njësive Bashkiake.
46. Mbi miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore për të cilat Bashkia e Tiranës kërkon transferimin në pronësi të saj.
47. Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.15, datë 10.3.2004 “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit”

48. Për një shtesë fondi investimesh për rikonstrukcionin e godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore (faza e dytë)
49. Mbi zgjedhjen e shtatë anëtarëve të KRRT-së të Bashkisë së Tiranës.
50. Mbi disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2007.
51. Për ngritjen e inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës.

Datë 29.10.2007

52. Mbi riorganizimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës.
53. Për disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKM Nr.434, Dt.13.7.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 551, Dt. 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.
54. Mbi zbatimin e vendimit të Gjykatës dhe reflektimin në listën e pjesshme e inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës.
55. Për krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij.
56. Për disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të Njësive Bashkiake të Tiranës në mbështetje të VKM Nr.434, Dt.13.7.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 551, Dt. 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.
57. Mbi detajimin e fondit të projekteve miratuar me VKB Nr.23 Dt.30.4.2007.
58. Mbi zbatimin e vendimit të Gjykatës për sipërfaqen 516 m² (Objekt i Drejtorisë Nr.3 të Qytetit) dhe reflektimin në listën e pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës.
59. Për krijimin dhe funksionimin e mencës në Qendrën Sociale “Të qëndrojmë së bashku” si dhe për miratimin e një ndryshimi në strukturë.
60. Mbi krijimin e sporteve të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) pranë Bashkisë Tiranë dhe miratimin e klasifikimit të pagave të punonjësve të kësaj Qendre.

Datë 30.11.2007

61. Për miratim dhënie burse shteti, nxënësve dhe studentëve, për vitin shkollor 2007 – 2008.
62. Për miratimin e “Bonusi i të porsalindurit”.

Datë 06.12.2007

63. Për disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të vartësisë.
64. Për disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë së Tiranës, për vitin 2007, miratuar me me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 23, datë 30.04.2007.
65. Për përfundimin e procedurave të privatizimit të disa apartamenteve, të cilat

kanë mbetur pa u rregjistruar pranë Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

66. Për rishikimin e Lejes së Ndërtimit Nr. 96, datë 06.06.2006, në favor të subjektit ndërtues “Aral Construction” Sh. P. K.
67. Mbi miratimin e dhënies me qira të objektit me sipërfaqe mbi 200 m² të pasurive të ndërmarrjeve në administrim të Bashkisë.
68. Mbi miratimin në parim të dhënies me qira të objekteve me sipërfaqe 200 – 500 m² të pasurive të ndërmarrjeve në administrim të Bashkisë.
69. Mbi miratimin në parim të dhënies me qira të objekteve me sipërfaqe 200 – 500 m² të pasurive të ndërmarrjeve në administrim të Bashkisë.
70. Mbi financimin e shpenzimeve të shërbimit funeral të të ndjerës Violeta Manushi (Artiste Populli), të kryera më datë 27.07.2007.

Datë 27.12.2007

71. Për riorganizimin e Qendrës Kulturore “Tirana”.
72. Për transferim fondesh brenda fondit të investimeve.
73. Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 15, datë 10.03.2004, si dhe për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 33, datë 01.07.2004.
74. Për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut.
75. Për kalimin në fond banese të objektit “Ish-reparti i këpucarisë”, në Rrugën e Kavajës, Tiranë.
76. Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 6, datë, 26.01.2001 “Për vendosjen e gjobave nga Bashkia Tiranë” (i ndryshuar).
77. Për një shtesë bursash në Vendimin Nr. 61, datë 30.11.2007 “Për miratim dhënie burse shteti, nxënësve dhe studentëve, për vitin shkollor 2007 – 2008”
78. Mbi miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës.
79. Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 56, datë 29.10.2007 “Për disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë së Tiranës në mbështetje të V.K.M. Nr. 434, datë 13.07.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr 551, datë 07.11.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” të ndryshuar.
80. Për mbarimin para afatit të mbarimit të afatit të mandatit të këshilltarit Z. Irfan Ali Dashi dhe dhënien e mandatit znj. Edlira Tahir Haxhiymeri

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE DHE BURIMEVE NJERËZORE

a. Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Në Bashkinë e Tiranës janë të punësuar 394 persona nga të cilët 251 janë femra. Personeli i Bashkisë së Tiranës mund të klasifikohet në këto grupe sipas:

I. Nivelit arsimor

- 16 persona me arsim të ulët
- 65 persona me arsim të mesëm
- 313 persona me arsim të lartë nga të cilët 39 persona kanë kryer shkollë pasuniversitare dhe 2 persona kanë një titull shkencor

II. Grupmoshës

- 78 persona janë të moshës 20-30 vjeç
- 115 persona janë të moshës 31-40 vjeç
- 95 persona janë të moshës 41-50 vjeç
- 96 persona janë të moshës 51-60 vjeç
- 10 persona janë mbi 60 vjeç

III. Viti i fillimit të punës në Bashki

- 53 persona kanë filluar para vitit 2000
- 308 persona kanë filluar në periudhën 2000-2006
- 33 persona në vitin 2007

Gjatë vitit 2007 janë zhvilluar 28 konkurse nga të cilët:

- 3 për Drejtor
- 7 për Përgjegjës Sektori
- 18 për Specialistë

Të dhënat mbi dokumentet e protokolluara gjatë vitit 2007 nga **Sektori i Arkiv-Protokollit** janë si më poshtë:

Dokumente të protokolluara

Viti 2007

Urdhra të Kryetarit	Shkresa të brendshme	Shkresa të jashtme
862	3,228	19,054

b. Drejtoria e Financës

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave

Viti
2007

Nr.	Emërtimi	3 Mujori IV	3 Mujori III	3 Mujori II	3 Mujori I	Prej fillimit të vitit	Gjendja në fund	Femra
I.	Punonjës gjithsej (aparati)	627	597	533	516	492	627	254
	Drejtues	92	93	90	85	85	92	55
	Specialist me arsim të lartë	278	244	233	231	229	278	145
	Teknik dhe specialistë në zbatim							
	Nëpunës të thjeshtë	187	190	141	130	109	187	24
	Punëtorë	70	70	69	70	69	70	30
II.	Punonjës gjithsej nga të cilët:	627	597	533	516	492	627	254
	Buxhetorë - Gjendja Civile	3	3	3	3	3	3	3
	Jobuxhetorë	624	594	530	513	489	624	251
III.	Fondi i pagave (000/lekë)	367,922	219,462	143,596	-	-	367,922	-
	Për drejtues	86,320	64,083	41,828	-	-	86,320	-
	Për specialistë me arsim të lartë	183,961	98,758	64,683	-	-	183,961	-
	Për teknik dhe specialistë në zbatim							
	Për nëpunës të thjeshtë	78,540	43,014	28,173			78,540	
	Për punëtorë	19,101	13,607	8,912			19,101	
IV.	Fondi i pagave (000/lekë) gjithsej nga i cili:	330,469	219,462	143,740	-	-	330,469	-
	Për buxhetorë (Gjendja Civile)	1,167	515	359			1,167	
	Për jo buxhetorë	329,302	218,947	143,381			329,302	
V.	Kompensimet gjithsej	2,050	1,039	111				
VI.	Fondi i pagave (000/lekë) si kontribut i Sig.Shoq.	174,197	43,690	28,586	-	-	62,743	-
	Për buxhetorë (Gjendja Civile)	237	154	102			237	
	Për jo buxhetorë (aparati)	173,960	43,536	28,484			62,506	

c. Drejtoria e Përkujdesit social

Shërbimet Sociale

Gjatë vitit 2007, nga kjo Drejtori është punuar për të realizuar këto projekte në fushën e shërbimeve sociale:

- 1 Qershor-"Telajo e ëndrrave, qyteti i ngjyrave" - organizuar nga Bashkia e Tiranës (44 mijë lekë) dhe donator ProCredit Bank (120 mijë lekë) dhe SHIS (700 Euro)
- Kënd lojrash për fëmijët e Kopshtit Nr. 36 - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator Raiffeisen Bank (2,000 Euro)
- Qendër komunitare multidisiplinare për fëmijët dhe familjen - realizuar nga Bashkia e Tiranës (3,815 mijë lekë).
- Të qëndrojmë së bashku - organizuar nga Bashkia e Tiranës (3,594 mijë lekë).

- Rikonstruksioni i mencës në Qendrën Sociale "Të qëndrojmë së bashku" - realizuar nga Bashkia e Tiranës (2,297.4 mijë lekë)
- 8 Prilli - Dita ndërkombëtare e Romëve - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator VIS-Tirana (500 Euro)
- Rehabilitimi i çerdhes Nr 8 - realizuar nga Bashkia e Tiranës (26,500 mijë lekë)
- Rehabilitimi i çerdhes Nr 10 - realizuar nga Bashkia e Tiranës (26,500 mijë lekë)
- Qendra Sociale "Shtëpia e përbashkët" - realizuar nga Bashkia e Tiranës (43,672 \$ + ndërtesën) dhe donator Banka Botërore dhe Shoqata "Shpresë dhe Dashuri" të cilat së bashku kanë financuar këtë projekt me 128,450\$
- Qendër shërbimesh psikosociale për njerëzit në nevojë dhe vuajtje - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator Banka Botërore dhe Shoqata Shqiptare e Trajtimit të Dhimbjes të cilat së bashku kanë financuar këtë projekt me 100,000\$
- Qendër komunitare socialkulturore rinore FORIS - realizuar nga Bashkia e Tiranës (17,640 \$ + ndërtesën) dhe donator Banka Botërore dhe Shoqata FORIS të cilat së bashku kanë financuar këtë projekt me 214,888\$
- Porta parandaluese e HIV-AIDS - realizuar nga Bashkia e Tiranës (14,000 \$) dhe donator Banka Botërore dhe Shoqata APRAD të cilat së bashku kanë financuar këtë projekt me 115,000\$
- Kënd lojrash për fëmijët e Çerdhes Nr. 1 - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator Banka Italo-Shqiptare (2,000 Euro)
- Kënd lojrash për fëmijët e Kopshtit Nr. 52 - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator Raiffeisen Bank (2,000 Euro)
- Kënd lojrash për fëmijët e Çerdhes Nr. 8 - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator Raiffeisen Bank (2,000 Euro)
- Kënd lojrash për fëmijët e Kopshtit Nr. 25/1 - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator Raiffeisen Bank (2,000 Euro)
- Pajisje palestrash dhe hapësira rekreative për pesë shkolla të mesme dhe një shkollë 9-vjeçare - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator Raiffeisen Bank (21,000 Euro)
- Shpërndarja e mjeteve didaktike për fëmijët e familjeve me të ardhura të pamjaftueshme - realizuar nga Bashkia e Tiranës (290.4 mijë lekë).
- Forcimi i kapaciteteve në Drejtorinë e Përkujdesit Social dhe Forcimi i rrjetit të Qendrave Ditore - realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe donator Shoqata Internacionale për Solidaritet (1,500 Euro).
- Qendra Ditore Komunitare për të Moshuar në Njësitë Bashkiake Nr. 7, 8 - realizuar nga Bashkia e Tiranës (974 mijë lekë) dhe donator Kryqi i Kuq Dega Tiranë (1,375 mijë lekë).
- Pilotimi i skemës së re të ndihmës ekonomike të shoqëruar me punë në komunitet me Njësitë Bashkiake Nr. 1,5,6,8,9,11 - realizuar nga Bashkia e Tiranës (16,887.406 mijë lekë) dhe Njësitë Bashkiake Nr. 1,5,6,8,9,11 (4,509.060 mijë lekë).
- Të mësojmë duke vepruar - realizuar nga Bashkia e Tiranës (2,522.700 mijë lekë).
- Rehabilitimi i çerdhes Nr 35 - realizuar nga Bashkia e Tiranës (939.952 mijë lekë)

- Qendra Komunitare Social – Kulturore Rinore FORIS – realizuar nga Bashkia e Tiranës (17,640 \$ + ndërtesa) dhe donator Banka Botërore (214,888 \$), Shoqata FORIS
- 1 Tetor – Dita Ndërkombëtare e Moshës së Tretë – realizuar nga Bashkia e Tiranës (250 mijë lekë) dhe donator UNFPA (260 mijë lekë).
- Festimi i Vitit të Ri – realizuar nga Bashkia e Tiranës (26 mijë e pesëqind lekë).

d. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ndër **projektet kulturore** të realizuara nga kjo drejtori gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2007 përmendim:

14 Mars Dita e Verës
Organizuar nga Bashkia e Tiranës (376 mijë lekë).

1 Qershor 1 Qershori - Festa e Fëmijëve
Organizuar nga Bashkia e Tiranës (192.45 mijë lekë).

23-28 Qershor Këngët e Tokës
Organizuar nga Qendra e Menaxhimit Artistik “Këngët e Tokës” (60 mijë lekë), Bashkia e Tiranës (300 mijë lekë), Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (308 mijë lekë), Qendra “Dea” (208 mijë lekë), “Egi” sh.p.k. (90 mijë lekë), Shkolla “Inkus” (37 mijë lekë), Parfumeri “Pupa” e cila ka vënë në dispozicion simbolet.

13-15 Qershor Përfaqësimi i qytetit të Tiranës në aktivitete kombëtare të folkut shqiptar
21-22 Qershor
Organizuar nga Bashkia e Tiranës (185 mijë lekë).

9 Qershor Performancë me nxënës të Liceut Artistik “Jordan Misja”
Organizuar me nismën e Znj. Etleve Turkeshi me financim të Bashkisë së Tiranës (200 mijë lekë) dhe donator “E-magic” Multimedia Studio (50 mijë lekë).

15 Qershor Ndryshimi i qytetit tim
Organizuar nga Shoqata “Gjurmë në Art” (120 mijë lekë) dhe Bashkia e Tiranës (200 mijë lekë).

23 Qershor Qershori i fëmijëve
Organizuar nga Shoqata “Rinia, Biznesi dhe e Ardhmja” (230 mijë lekë) dhe Bashkia e Tiranës (460 mijë lekë)

15 Qershor Çmimet Kult 2007
Organizuar nga Qendra “Akademia Kult” me financim të Bashkisë së Tiranës (1,500 mijë lekë), Union Bank (4,000 Euro), Porsche (4,000 Euro), Austrian Airlines (4,500 Euro), AMC (10,000 Euro), Unioni Financiar (6,000 Euro), Vizioni Plus (500 mijë lekë), Birra Korça (800 mijë lekë) dhe nga shitja e biletave 790 mijë lekë.

21 Qershor Muzikë për të gjithë
Organizuar me nismën e Z. Bujar Sykja me financim të Bashkisë së Tiranës (1,230 mijë lekë), aplikuesi (230 mijë lekë) dhe Ambasada Spanjolle (500 mijë lekë).

- 16 Shtator** Peza on the Rock '07
Organizuar nga Shoqata “Ëndrra për muzikën” dhe Bashkia e Tiranës (1,282 mijë lekë)
- 9 Nëntor** Festivali i 8-të Ndërkombëtar i Vokalit Operistik të Shqipërisë
Organizuar nga Shoqata “Kulturë – Media – Art” me financim të Bashkisë së Tiranës (1,450 mijë lekë) dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (1,800 mijë lekë); Sheraton (200 mijë lekë); Rogner (150 mijë lekë); Instituti Italian i Kulturës (1,250 mijë lekë); Banka Amerikane (2,270 mijë lekë); AMC (1,370 mijë lekë).
- 11 Nëntor** Koncert instrumental
Organizuar me nismën e Znj. Adriana Dizdari, me financim të Bashkisë së Tiranës (180 mijë lekë), Qendrës “Dea” (45 mijë lekë) dhe Inkus (30 mijë lekë).
- 14 – 19 Nëntor** Panairi i librit
Organizuar nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë, me financim të Bashkisë së Tiranës (800 mijë lekë) dhe Shoqatës së Botuesve Shqiptarë (4,915 mijë lekë).
- 15 Nëntor** Diamanti i Cirkut
Organizuar me nismën e Z. Verdi Take, me financim të Bashkisë së Tiranës (200 mijë lekë) dhe Z. Lytifi Nuri (50 mijë lekë); Z. Bujar Hyka (20 mijë lekë); Z. Teodor Dhoska (20 mijë lekë); Z. Kosta Papanikolla (12 mijë lekë).
- 17 Nëntor** Tira Muza
Organizuar nga Shoqata “Miqte e Muzikës”, me financim të Bashkisë së Tiranës (778 mijë lekë).
- 20 Nëntor** Vjeshta e Tiranës
Organizuar nga Shoqata “Qendra për dokumentimin dhe Komunikimin e Muzikës Shqiptare dhe Rajonale (Ballkanike)”, me financim të Bashkisë së Tiranës (500 mijë lekë); Kulturor Kontakt Austria (600 euro); Ernst von Siemens Stiftung (4,600 euro); Stiftung Kunst und Kultur des Landes NRW (4,600 euro); Swedish Culture Institute (7,200 euro); Pro Helvetia (5,000 SFR).
- 26 Nëntor – 2 Dhjetor** Tirana International Film Festival'07
Organizuar nga Shoqata “Albania Art Institute”, me financim të Bashkisë së Tiranës (800 mijë lekë) dhe AMC (1,587 mijë e pesëqind lekë).
- 29 Nëntor** Pop Rrok – Koncert në ditën e Çlirimit
Të lindur për të lexuar
Organizuar nga Shoqata “Ari – Li – Shqip”, me financim të Bashkisë së Tiranës (1,035 mijë lekë) dhe Shoqatës “Ari – Li – Shqip” (100 mijë lekë).
- 29 Nëntor** Nata e Bardhë
Organizuar nga Shoqata “Instituti Shqiptaro – European”, me financim të Bashkisë së Tiranës (2,133 mijë lekë) dhe Shoqatës “Instituti Shqiptaro – European” (200 mijë lekë).
- 29 Nëntor** Koncert me rastin e 28 – 29 Nëntorit

Organizuar nga shoqata “E drejta dhe arti”, me financim të Bashkisë së Tiranës (1,035 mijë lekë) dhe Radio +2 (200 mijë lekë); Metro Sh. a.(100 mijë lekë); Planeti X Sh. p. k (300 mijë lekë).; Abissnet Sh. a (250 mijë lekë).

29 Nëntor Nata Rome
Organizuar nga Shoqata “Erzeni”, me financim të Bashkisë së Tiranës (350 mijë lekë) dhe Shoqatës “Erzeni” (20 mijë lekë).

Fillim Dhjetori Pjesa teatrale “Dëshmitari”
Organizuar me nismën e Z. Arben Kumbaro, me financim të Bashkisë së Tiranës (1,450 mijë lekë) dhe Z. Arben Kumbaro (940 mijë lekë).

Fillim Dhjetori Pjesa teatrale “Harvey”
Organizuar me nismën e Z. Hevin Çuli, me financim të Bashkisë së Tiranës (500 mijë lekë) dhe Qendrës Kulturore “Tirana” (2,010 mijë lekë); Firma “Alb – Eraldo” (1 milion lekë).

Fillim Dhjetori Muzikulturë
Organizuar nga Shoqata “Ëndrra për muzikën”, me financim të Bashkisë së Tiranës (300 mijë lekë) dhe Shoqatës “Muzikulturë” (245 mijë lekë).

10 Dhjetor Dua këndin tim të lojrave
Organizuar nga Shoqata “Gjurmë në Art”, me financim të Bashkisë së Tiranës (150 mijë lekë).

15 – 16 Dhjetor Pema ndriçohet!
Organizuar me nismën e Znj. Besa Kaçinari, me financim të Bashkisë së Tiranës (750 mijë lekë) dhe firmës “Manent” (30 mijë lekë)

17, 18 dhe 19 Dhjetor Krishtlindje të Bardha
Organizuar nga Shoqata “Milleniumshow Studio”, me financim të Bashkisë së Tiranës (1,294 mijë lekë) dhe Shoqatës “Milleniumshow Studio” (20 mijë lekë).

18 Dhjetor Transformimi i qytetit tim
Organizuar nga Shoqata “Mur”, me financim të Bashkisë së Tiranës (450 mijë lekë) dhe Shoqatës “Mur” (20 mijë lekë).

20, 21 Dhjetor Ndryshojmë përditë
Organizuar me nismën e Z. Pjetër Guralumi, me financim të Bashkisë së Tiranës (630 mijë lekë).

31 Dhjetor Gëzuar Tiranë
Organizuar nga Shoqata “Milleniumshow Studio”, me financim të Bashkisë së Tiranës (3,845 mijë lekë) dhe Shoqatës “Milleniumshow Studio” (200 mijë lekë)

Ndër monumentet e kulturore të rrethit të Tiranës përmendim

- Kalaja e Tiranës, bërthama historike e kryeqytetit
- Kisha e Kroit të Shëngjinit
- Kalaja e Prezës

- Kalaja e Petrelës
- Xhamia e Tiranës
- Qendra e Tiranës, Ansambël Monumental
- Ura e Tabakëve
- Varri i Kapllan Pashës në Tiranë
- Kulla e Sahatit

Në Tiranë ka gjithsej:

- 8 biblioteka një prej të cilave është Biblioteka Kombëtare
- 1 Muze Historik Kombëtar i vizituar nga 47,926 persona gjatë vitit 2006
- 5 Shtëpi muze dhe 56 monumente kulture
- 2 stadione futbollit të cilat i përkasin Klubit Futboll Tirana
- 2 stadione lojrash me dorë të cilat i përkasin Klubit Shumësporte Tirana
- 6 terrene sportive (4 prej tyre i përkasin Klubit Shumësporte Partizani, 1 Klubit Shumësporte Dinamo dhe 1 Klubit Sportiv Tirana)
- 4 fusha futbollit (të cilat i përkasin 2 Klubit Futboll Tirana dhe 2 Klubit Sportiv Futboll Dinamo)
- 1 pishinë e cila i përket Klubit Shumësporte Partizani
- 2 poligone qitjeje (1 Klubit Sportiv Tirana dhe 1 Klubit Studenti)
- 11 palestra (8 prej tyre i përkasin Klubit Shumësporte Partizani, 2 Klubit Sportiv Tirana, 1 Klubit Studenti)
- 1 sallë shahu, ping-pongu, etj. (e cila i përket Klubit Shumësporte Partizani)

Në Tiranë zhvillojnë aktivitete kulturore një sërë institucionesh si: Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, Teatri Kombëtar, Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore, Qendra Kulturore Tirana, Teatri Kombëtar për Fëmijë, Kinema Millenium, Galeria Kombëtare e Arteve.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE

a. Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar

Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës përfshijnë të ardhurat e veta nga Taksat dhe Tarifat Vendore dhe të ardhurat nga Buxheti i Shtetit si fondet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara.

Realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2007 duke përfshirë dhe fondin e mbartur nga viti 2006, kapin shifrën 3,331,811 mijë lekë.

Realizimi i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës

Viti 2007

Nr	Emërtimi	Parashikimi për vitin 2007 (000/lekë)	Realizimi për vitin 2007 (000/lekë)	%
I	Të ardhurat të taksueshme (1+2+...+9)	3,461,000	2,264,201	65
1	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	540,100	394,892	73
2	Taksa mbi biznesin e vogël	1,100,000	859,477	78
3	Taksa e fjetjes në hotel	56,000	68,839	123
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,100,000	199,081	18
5	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pas. e paluajt.	150,000.	314,600	210
6	Taksa për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve	200,000	188,134	94
7	Taksa për zënien e hapësirave publike	29,500	50,979	173
8	Taksa për tabelën	99,000	68,018	69
9	Taksa e përkohshme e gjelbërt	186,400	120,183	64
II	Të ardhura jo tatimore (1+2+3)	860,510	632,449	73
1	Tarifat	740,510	515,814	70
2	Të ardhura të tjera	23,500	24,021	102
3	Pagesa	96,500	92,614	96
III	Sponsorizime dhe donator	3,072	3,072	100
IV	Gjobat	40,200	86,142	214
	Gjithsej (I+II+III+IV)	4,364,782	2,985,864	68
	Fondi i mbartur nga viti 2006	345,946	345,946	100
	Të ardhurat gjithsej	4,710,728	3,331,811	71

Tabelat e mëposhtme paraqesin investimet, shpenzimet buxhetore dhe shpenzimet nga të ardhurat për periudhën Vitin 2007:

Realizimi i investimeve

Viti 2007

Nr	Emërtimi	Plani (000/lekë)	Realizimi (000/lekë)	%
1	Investime Buxhetore	88,140	40,118	50
	Ndërtim-montime	88,060	39,796	45
	Makineri e pajisje	-	-	-
	Studime e projekttime	-	-	-
	Shpim-kërkime	-	-	-
	Investime të tjera	350	322	92
2	Investime të realizuara me mjetet e veta	2,388,212	966,609	40
	Ndërtim-montime	1,651,764	731,441	44
	Makineri e paisje	309,191	68,971	22
	Studime e projekttime	60,640	4,236	6
	Shpim-kërkime	-	-	-
	Investime të tjera	366,617	161,961	44
	Gjithsej	2,476,622	1,006,727	41

Shpenzime buxhetore

Viti 2007

Nr	Emërtimi	Plani (000/lekë)	Realizimi (000/lekë)	%
1	Min. Arsimit dhe Shkencës	1,748,243	1,745,878	100
2	Administrata Vendore	87,122	81,679	94
3	Shërbime Sociale	984,910	971,540	99
4	Shpenzime varrimi	30,000	24,772	83
	Gjithsej	2,850,275	2,823,869	99

Shpenzime nga të ardhurat

Viti 2007

Nr	Emërtimi	Plani (000/lekë)	Realizimi 000/lekë	%
1	Sistemi i Punëve Publike	860,465.0	1,038,581	87
2	Administrata Vendore	1,164,740	931,733	80
3	Sistemi i Kulturës	124,375	110,786	89
4	Subvencion	25,000	25,000	100
5	Shërbime Sociale	40,835	12,194	30
6	Sistemi i Arsimit	483,106	450,428	93
7	Të tjera	18,996	20,097	106
	Gjithsej	3,046,912	2,588,819	85

b. Drejtoria e Administrimit të Aseteve

Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2007, nga **Drejtoria e Administrimit të Aseteve** në bashkëpunim me ndërmarrjet e varësisë për ambientet e dhëna me qera, jepen në tabelën e mëposhtme:

Të ardhura nga qeradhënia

Viti 2007

Nr	Emërtimi i sipërfaqes m ²	Nr. i kontratave	Sipërfaqja në m ²		Përfitimet e Bashkisë
			Nën objekt	Truall	Vlera (000/lekë)
1	0-200	110	10,193	305	3,715
2	200-500	12	3,573	3,573	2,676
3	mbi 500	11	26,610	26,610	2,041
	Gjithsej	133	40,376	57,367	8,432

c. Drejtoria e Dhënies së Lejeve për Ushtrim Aktiviteti

Gjatë vitit 2007, nga kjo Drejtori janë liçensuar 2,190 subjekte në transport si dhe janë dhënë 71 leje për ushtrim aktiviteti

Të ardhurat e grumbulluara nga kjo drejtori për këtë periudhë janë 7,507 mijë lekë.

Subjekte të liçensuara në transport

Viti 2007

Nr	Emërtimi	Nr	Vlera (000/lekë)
1	Çertifikatë transporti malli për llogari të vet	1,643	3,720.6
2	Liçencë, çertifikatë transporti malli për të tretë dhe me qera	176	451.3
3	Autorizim transporti i mallrave brenda unazës	11	124.0
4	Liçencë transporti i udhëtarëve me taksi 4+1	259	1,965.4
5	Liçencë transporti i udhëtarëve me taksi 8+1	13	162.4
6	Liçencë agjensi transporti udhëtarësh dhe taxi	3	9.0
7	Autorizim për transportin e udhëtarëve ndërmjet qyteteve jashtë qarkut	4	12.0
8	Konfirmim i kushteve të autorizimit për transportin e udhëtarëve ndërmjet qyteteve jashtë qarkut (përsëritje)	10	45.0
9	Liçencë, çertifikatë transporti i udhëtarëve ndërmjet qyteteve brenda qarkut	-	-
10	Liçencë, çertifikatë transporti i udhëtarëve rrethqytetës	71	212.0
	Gjithsej	2,190	6,702

Leje ushtrim aktiviteti

Viti 2007

Nr	Emërtimi	Nr	Vlera (000/lekë)
1	Autorizim tregti lëndësh të rrezikshme	-	-
2	Leje ushtrimi i aktivitetit gjatë orëve të vona të natës	37	605
3	Leje për veprimtari kulturore, sportive dhe të tjera	21	200
4	Leje ushtrim aktiviteti në hapësirat publike	-	-
	Gjithsej	58	805

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Kjo Drejtori është struktura përgjegjëse për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore të përcaktuara në ligjet dhe vendimet e Këshillit Bashkiak si dhe ndjek marrëdhëniet me Agjentët Tatimorë për taksat dhe tarifat vendore.


Sipas të dhënave të regjistrit vendor të DPTTV për vitin 2007, bizneset të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Tiranës kategorizohen si më poshtë:

Njësi që i nënshtrohen tarifës së pastrimit

Viti 2007

Nr	Emërtimet	Gjithsej	Likujduar
1	Biznese në fushën e tregtisë	8,085	6,956
2	Biznese me karakter prodhues	855	751
3	Biznese në fushën e shërbimeve	11,058	9,702
